

## INTERVISTË ME INDIRA ÇIPA

Prishtinë | Data: 21 maj, 2018

Kohëzgjatja: 74 minutes

Të pranishëm:

- Indira Çipa (E intervistuar)
- Ardita Avdija (Intervistuesja)
- Donjetë Berisha (Intervistuesja/ Kamerë)

*Simbolet e komenteve në transkriptë të komunikimi jo-verbal:*

*() - komunikim emocional*

*{ } - i intervistuari shpjegon me gjeste*

*Simbole të tjera në transkriptë:*

*[ ] - shtesë e tekstit për të lehtësuar kuptimin*

*Fusnotat janë shtesa editoriale që japin informacion mbi vendbanime, emra apo shprehje.*

## **Pjesa e Parë**

**Ardita Avdija:** A mundeni me na tregu pak ose me folë pak për fëmijë të tande, atë pjesë, rininë tonde, diçka çka mban në mend prej kujtimeve ma të hershme të saj?

**Indira Çipa:** Po, gjithkujt, gjithkujt familja i duket ma e bukura, por unë vërtetë kam pasë një fëmijë të bukur. Unë jam vet e pesta në familje prej fëmijëve. Prindët e mi, baba im, inxhinier i agronomisë ndër të parët, i martuar me nanën time, Hyrmeten, mësuse. Kanë lindë pesë vajza, unë jam e dyta prej tyre edhe kemi pasë një fëmijë të lumtur. Me aq sa kemi pasë, ne kemi ditë të jemi të lumtur, ta ndiejmë lumturinë me pak gjëra. Ka qenë një kohë ndryshe nga kjo e sotshmja që dikton shumë nevoja, kërkon shumë nevoja, shumë investime për të qenë i lumtur.

Ne kemi qenë të lumtura me pak gjëra, sikurse edhe të gjithë të tjerët si kanë jetu. Më kujtohet... ne kemi jetu me një banesë të vogël, po shumë e dashtun, shumë e lezetshme. Në fqinjësi kemi pasë shumë fëmijë, rreth e rreth banesave dhe ndërmjet banesave ka pasë hapësirë shumë të mjaftueshme për lojëra të ndryshme. Por sikur ajo fëmijë shumë shpejt u ndërpre sepse fillumë të shkojmë në shkollë dhe menjëherë pas shkollës unë fillova të shkoj edhe në shkollë të muzikës, dhe kjo pakëz ma shkurtoi ndoshta, ndoshta atë lojën me shokë e me shoqe.

Edhe pastaj jetën time e përfshiu shkolla, e përfshiu shkolla e muzikës, me shumë koncerte, me shumë gara, festivale dhe njeriu jeton me ate që ka, me ate që krijon edhe ajo pjesë ka qenë shumë e kandshme për mu, ka qenë shumë aktive, me shumë koncerte, me shumë aktivitete. Veç asaj edhe shkolla, edhe shkolla e muzikës, përveç asaj ne në shkollë kishim edhe aktivitete të tjera, për shembull në çdo shkollë ka pasë edhe aktivitete, tash fëmijët shkojnë nëpër kurse të veçanta jashtë shkollës, në një ndërtesë të largtë, ne të gjitha i kemi pasë brenda shkollës.

Më kujtohet që në moshën tetë-nantë vjeçare kam lujtë edhe në Ansamblin e Folklorit të shkollës. Pastaj ma vonë dikund në moshën dymdhjetë-tremdhjetë vjeçare, arsimtarët e vërejtën që unë edhe shkruaj bukur, mandej isha edhe anëtare e klubit të letrarëve që organizohej. Kështu që, ka qenë një jetë përplot aktivitete, me punë shumë dhe rezultate që vëreheshin shpejt dhe mirë në mënyrë shumë reale. Edhe unë si vet e pesta prej motrave, ne kemi jetu shumë bukur, kemi kalu shumë bukur. Ende sot e kësaj dite kemi një marrëdhënie shumë të mirë.

Të jesh anëtare e një familje ku ka shumë fëmijë ndonjëherë sikur s'ki nevojë për shokë e shoqe, sepse të gjithë atë nevojë që e ke, e përmbush me motra, por as kjo pjesë tjetër s'ka, s'ka qenë e mangët sepse ne kemi pasë kushte, kemi pasë mundësi. Ne s'kemi pasë frikë të dalim rrugëve prej veturave. Kemi lujtë shumë, jemi shoqnu shumë, jemi deshtë shumë edhe kjo është ajo begati që edhe siguri, bukuri, lumturi që të mban për tanë jetën. Kështu ka qenë fëmijëria ime edhe kam pasë, i kam ende dy prindë të mrekullueshëm që kanë ditë me na përkrahë, por s'na kanë lazdru shumë, kanë qenë shumë real.

Dhe me këtë rast duhet ta përmendi edhe stërgjyshin tim, i cili kur isha unë pesë vjeçe, gjashtë vjeçe, ai filloi të më mësojë të shkruaj. Ai atëherë ka kry ruzhdije<sup>1</sup>, ruzhdije ka qenë një Shkollë e Lartë, universiteti i parë që njihet në këto troje. Ai vet ka folë katër gjuhë, ka shkru tri alfabete, një person shumë i ngritur, shumë i gjanë dhe që të gjitha neve na kanë dhanë shumë forcë dhe shumë guxim. Dhe po më vjen mirë që kam rast me e përmend atë.

**Ardita Avdija:** Na përmendët që keni qenë në shkollë të muzikës. A kanë qenë prindërit e tu ata që të kanë shty me vazhdu këtë pjesën muzikore tandem, apo ti ke vendos vet edhe e ke mendu vet me shku në shkollë të muzikës?

**Indira Çipa:** Kështu, shkolla e parë e muzikës në Kosovë osht' hapë në vitin 1948, ajo është, ajo është shkollë e Prizrenit dhe ka qenë një lloj ndoshta edhe prestigj edhe një garë mes prindëve që fëmijëve t'ju japin sa ma shumë mundësi që të edukohen dhe arsimohen. Dhe e para, motra ime e madhja, ajo ma s'pari osht' regjistru në shkollë të muzikës, mandej unë. Radhazi, por të gjitha neve na kanë regjistru në shkollë, në shkollë të muzikës; dhe njena ka shku pesë vjet, tjetra ka shku katër vjet, ajo tjetra gjashtë vjet. Atëherë ka qenë shkolla e muzikës gjashtë-vjeçare edhe unë u regjistrova, eh është pakëz jo e saktë nëse themi fëmiu ka deshtë.

Prindi është ai që e udhëzon dhe e çon, dhe prindët e mi kanë qenë ata që neve na kanë çu, na kanë regjistru, edhe unë isha e vetmja që vendosa me e shndërru këtë në profesion dhe ishte, pasi e përfundova shkollën e ultë, filloi atëherë të themelohet fakulteti i muzikës dhe u themelu edhe dega e pianos edhe profesorët e shkollës kishin interesim që dega e pianizmit të hapet edhe në Prizren dhe unë isha e para dhe e vetmja. Dhe profesorët bisedun me prindërit, "Të ia mundësojmë Indirës, le ta vazhdoj edhe shkollën e mesme të muzikës, por pa e ndërpre gjimnazin".

Kështu që, unë shkova edhe në gjimnaz edhe në shkollë të mesme të muzikës dhe kur mbërrina në maturë, i organizova nja dy koncerte solistike për diplomë edhe mendova se me atë do ta ndërprej. Edhe ndodhi që në koncertin e fundit kur shkova, rrugës t'u shku, mendova, thashë kjo nuk guxon të jetë e fundit me piano. Edhe aty ishte, aty unë mora vendim që pianon ta fus dhe ta shndërroj në profesion, dhe nuk shkova në ndonjë fakultet tjetër. U regjistrova në Fakultetin e Arteve, ishte viti 1981, atëherë u bëra studente, por në një kohë shumë të vështirë.

<sup>1</sup> Turk.: *Rüştiye*, do të thotë shkollë e mesme, ndryshe maturë, maturim.

Pas asaj valës së parë të demonstratave edhe pse ndoshta gjeneratat para meje kanë pa edhe ndonjë kohë që ka qenë edhe ma e vështirë. Për shembull, kanë qenë edhe më të vështira ato vitet '58, '50-ta, domethënë '58-ta, pastaj përpjekjet e mëdhaja në vitet e '60-ta që Kosovës të i jepet një status pak ma i mirë. Pastaj ajo kushtetuta e '74-tës sikur solli diçka të mirë, po ajo nuk zgjati shumë. Me '81-shin përsëri, sepse kërkesat tona nuk ishin definitive nuk u përmbyllën definitivisht, po flas për kërkesat tona kombëtare.

Edhe '81-shi ishte viti kur unë në njëfarë dore e braktisa Prizrenin, erdha në Prishtinë, por në një situatë jo mjaft të mirë edhe e gjithë gjendja ishte shumë e tendosur. Por, sikur popullata atëherë luante në dy palë binarë. Një është tendenca për nevojat tona nacionale, që ato të realizohen njëherë e përgjithmonë mirë dhe si duhet. Dhe pala tjetër e binarëve është jeta duhet të vazhdoj dhe duhet ta shfrytëzosh çdo moment që të arrish diçka, t'i krysh obligimet e tua edhe kjo ishte ajo situatë.

**Ardita Avdija:** Si e ke përjetu ti atë sistemin e atëhershëm, që veç edhe na fole pak, po mendoj si një e re në atë kohë? Qysh je ndje ti?

**Indira Çipa:** Edhe tash kam shqetësim. Nuk ishte e lehtë, ishte shumë e vështirë. Më kujtohet isha në gjimnaz, kishim disa shokë që ishin pak ma të guximshëm se shumica ne. Ka pasë të tillë që janë burgosë edhe si të mitur. Çkado që flisje, gjithçka të merrej në shënjestër. Është dashtë me qenë shumë i kujdesshëm çka po flet. Pasojat kanë mujtë me qenë shumë të randa, shumë të vështira, deri në atë masë. Bile edhe nëse ty drejtëpërdrejtë nuk të ndodhte, vetëm fakti që ndodhte rreth teje ishte një frikë edhe një pasiguri edhe ishte një dhimbje edhe për ata rreth teje që ju ndodhte.

Kështu që, ka qenë prej moshës domethënë atëherë 18-19 vjeçare e ma tej jeta ime rinore ka kalu në ankth, në dhimbje për të tjerët, në pasiguri për vete, në një... me një besim se ne shumë kemi të drejtë dhe duhet ta bëjmë, por fatmirësisht e banëm. E banëm. E kisha niherë ni shok, më thoshte, mërzitëshim ne shumë në kohën kur fillova me punu, në vitet e... mas '85-të deri '90-tën, ai ishte mjaft i angazhum rreth çështjeve kombëtare. Thashë, "Këtë punë duhet ta bajmë", po tha, "Indirë, duhesh me ditë" tha, "ne mbjellim për ta korrë të tjerët".

Thashë, "A je i sigurtë që gjyshi im s'e ka thanë këtë?" E ka thanë edhe gjyshi im. Prandaj thashë, "Ne duhet edhe ta mbjellim edhe ta korrim që të jemi të sigurt që të tjerëve ju kemi lanë diçka mirë". Ishte... tha, "Ma mbylle gojën". Edhe vërtetë ishte ashtu, se unë kisha shumë, shumë fjalë nga gjyshi edhe nga stërgjyshi, por edhe nga prindët që populli shqiptar në Kosovë kishte gjëra të papërfunduara, kishte andrra të porealizuara. Sa kanë guxu ata me folë, sa kanë qenë të hapur ata me neve është çështje relative, sepse edhe ata i kanë pasë frikat edhe ndrojtjet e tyre, sepse fëmija e merr fjalën prej babit edhe e qet jashtë, po mandej çka mundet me ndodhë?

Kështu që, sa është e dhimbshme që kam jetu në një kohë me shumë turbullira, aq është krenari që unë megjithatë e përjetova lirinë. Fatmirësisht në njerëz të afërt unë nuk përjetova, humbje materiale po, por shpirtnisht, fatmirësisht nuk përjetova ndonjë humbje të madhe por edhe humbjeve të të tjerëve nuk është që nuk të dhambin aq sa edhe të afërmit e tu.

**Ardita Avdija:** Përtej aspektit të trazirave politike në atë vakt, a mendon që kjo ka qenë një shtysë edhe njëherë ma e madhe për zhvillim tond profesional, meqë dihet...

**Indira Çipa:** Po, ne vazhdimisht kemi qenë në garë, ne kemi qenë vazhdimisht në garë. Shife, luftat, trazirat janë akti i fundit i trysnisë, i presionit. Lufta në fakt fillon shumë ma herët. Nëse një luftë zgjat shtatë, tetë mujë, dihet që nja shtatë, tetë vjet ke pasë një presion sepse paraprakisht fillon m'u përgatitë. Ne kemi qenë vazhdimisht nën presionin e asaj, sepse ushtrohej një bindje, "Ah shqiptarët nuk vlejné, ah shqiptarët nuk dinë, ah shqiptarët kush janë ata?" Dhe ne kemi qenë vazhdimisht në garë që të dëshmohe mi se ne vlejné, se ne dimë, se ne mund të mësojmë, se ne mund të arrijmë më shumë se ata. Në një rast njëherë, pata thanë një fjalë, të tjerët, sllavët neve na kanë pranë vetëm në raste kur ke qenë shumë ma i mirë se ma i miri i tyre. Kaq ka qenë e vështirë. Domethanë, për t'u dëshmu, për ta pranë vlerën, është dashur të punosh shumë ma shumë se sa ma i miri i tyre, për të thënë, "Ah në rregull". Dhe kemi pasë ne luftëra të tilla dhe gara të tilla edhe në njohjen e gjuhës edhe në njohjen e artit edhe në njohjen e shkencës edhe në kulturë.

**Ardita Avdija:** Nëse mund të...

**Indira Çipa:** E përmenda pak ma herët që ne kemi luftë në dy palë binarë; një është gjendja e përgjithshme dhe binarët tjerë janë mundësitë që ti i shfrytëzon ose nuk i shfrytëzon. Unë profesorin e pianos e kam pasë serb, Saviq Marko, por person i mrekullushëm. Në të gjithë këtë ankesë që unë e pata deri tash, brenda asaj ankese ka pasë njerëz të cilët kanë qenë të shkarkum prej, prej negativiteteve kolektive. Ai ka qenë shqiptarofil i cili ka ndihmu shumë, shumë shqiptarë gjatë shkollimit, jo vetëm mu, po edhe të tjerët. Ka qenë pianisti i parë në Kosovë, i lindun në Prizren me një kulturë prizrenase shumë të mirë dhe ai neve na ka përkrahë shumë.

Na ka mësu shumë dhe na ka udhëzu shumë drejtë, shumë drejtë dhe përveç që na ka eduku profesionalisht, ka pasë një gjërësi shumë të madhe njerëzore. Ne jemi eduku me te përmes kulturës të tij që e ka pasë, ai e ka transferu dhe ka lanë një vulë te ne dhe kushdo që është shkollu në durtë e tij ka qenë shumë i kënaqun me sjelljet e tij edhe me dijen që e ka marrë. Dhe unë edhe shkollën e ultë edhe të mesmen në piano edhe fakultetin e kam kry me te dhe kam kujtime shumë të mira. Dhe ai asht' një prej personave i cili ka pasë guxim ta kundërshtojë politikën që është udhëheqë kundër shqiptarëve.

Bilem më kujtohet sikur sot një moment shumë i bukur edhe prekës. Ishte... ne kremtojmë 50 vjetorin e shoqërisë "Agimi" dhe kishim shumë intelektualë që kishin ardhë për festë për me shënu atë ditë, domethanë viti '94. Por e gjithë ajo ceremoni që u organizu ka qenë nën rrethimin e policisë, me vëzhgimin e policisë. Bile edhe mu më ndali policia, ma hapi çantën, më futën në një dyqan, i morrën letrat, dokumentet, listat e emrave, kush është prezent, unë nuk e di si shpëtova. Dhe ka qenë një situatë shumë e çuditshme në Prizren, por i gjithë Prizreni frymonte me kremtimin e 50 vjetorit sepse ishte ngjarje shumë e rëndësishme jo vetëm për kulturën e Prizrenit, por edhe për identitetin shqiptar në Kosovë.

Edhe ndodhi ajo akademi solemne, sende, të gjitha. Pas koncertit ne shkum të festojmë në Hotelin Theranda, aty ishte një darkë edhe vjen zonja e Fahri Beqirit, Myrvete Beqiraj, ajo me lotë në sy, qanë edhe thotë, “Indira, ti s’ke qare pa dalë jashtë, profesorin e ke jashtë, po qanë”. Profesori që më ka dhanë piano. Edhe dola unë jashtë, ai qaj, unë qaj, ai qaj, unë qaj, edhe tha, “Zoti i vraftë ata që na ndanë neve”. Domethënë, në të gjithë këtë storie të keqe, kjo është një dritë, një yll.

**Donjetë Berisha:** Cili vit është ky, më fal?

**Indira Çipa:** ‘94.

**Donjetë Berisha:** ‘94.

**Indira Çipa:** ‘94.

**Ardita Avdija:** M’u ndalë pak edhe te “Agimi”, pjesa interesante, po mendoj që i përket edhe Prizrenit edhe ti si një pjesëtare e saj, na trego pak për koncertet, për të gjitha ato idilat argëtuese që i ka shfaq “Agimi” në atë kohë.

**Indira Çipa:** “Agimi” është organizimi i parë kulturor pas Luftës së Dytë, në vitin ‘44 është formu, në nëntor edhe ka vepru me oscilime të ndryshme, herë ma shumë, herë ma pak, herë ma me kualitet, herë me ma pak kualitet. Por e ka rujtë shpirtin gjithmonë veprues, shpirti veprues ka qenë aty. Nëpër “Agimin” kanë kalu emra shumë, shumë të njohur të muzikës. Gati çdo muziktar tash që ka hy në historinë e muzikës në Kosovë, në biografinë e vet e ka, “Veproi në Shoqërinë Kulturore Artistike ‘Agimi’”. T’u fillu prej Engjëll Berishës, me Akil Koci, Mark Kaçinari, nuk e di a ka ndonjë emër që nuk i shënon në biografi Shoqëria “Agimi”.

Shoqëria Kulturore Artistike “Agimi” ndonjëherë ka dy-tre ansamble, ndonjëherë ka ma shumë ansamble. Në vitin ‘90 neve, të gjithëve na përjashtunë prej punëve, mbetëm pa punë, hynëm me të dy kambtë, me kokë e me shpirt, brenda skamjes dhe ishte shumë e vështirë për të gjithë ne. Njëherë, shëtisnim një ditë te shadërvanit unë dhe motrat, me disa shoqe dhe një prej shoqeve tona thotë, “Hajdeni bre” tha, “në ‘Agimi’” tha, “pus se pus qaty, barem po boj m diçka”, se ne të gjitha, artista, send, ne s’mund ta marrim pushkën edhe të shkojmë të luftojmë, të bëjmë diçka. Edhe fillim kështu të shkojmë në asi, në kor, unë bashkë me motrat e mija Agnesa dhe Adelina edhe disa shoqe edhe kështu gradualisht...

Atëherë kur ne fillim, kur ne shkum ishin nja, ndoshta, nja 25 veta. Brenda dy tre muajve u bonëm 80 persona, 80 persona, 80 këngëtarë në korin e “Agimit” dhe punojshim në vepra katër zanore, dirigjent kishim Dashnor Xërxën, një person i mrekullushëm. Shumë i aftë, shumë i shkathtë profesionalisht, por edhe personalisht ai rrezatonte, kishte një refleksion shumë të mirë. Po, ishim, u bonëm 80 persona, ndonjëherë ma shumë baheshim. Dhe në përbërje të korit kishte profesione të ndryshme, prej njerëzve që njofin notat deri te njerëzit që nuk njofin nota fare, prej një rrobaqepësi deri në doktor shkencash. Kishte mjekë...

**Donjetë Berisha:** E qysh i rekrutojshit këta artistë, këta persona?

**Indira Çipa:** Ka qenë edhe është ende ajo atmosferë. Ekziston ansambli dhe njerëzit vinë “Po du me knu”, vetëm e testojmë zanin, a duhet me shku në alto apo në bass apo në soprano edhe vendoset edhe fillon. Edhe tash të tillët kanë vështirësi të caktuara të leximit të notave. Ka pasë njerëz që me kohë kanë fillu m’i lexu notat. Fillunë m’i lexu notat, fillunë m’i lexu edhe vargjet m’i njoft, po shkon te naltë ose po shkon teposhtë. Por mbi të gjitha ka qenë ajo dashuri e brendshme e jona që frymonte brenda, ajo që na mbante, ajo që na lidhte, ajo ishte bërthama e gjithë asaj që ne bëjshim.

Neve na dukej që sa herë që shkojshim për prova, na dukej që kanga jonë ka me i’ a therrë shpirtin armikut që po na e cenon lirinë dhe dashurinë. Kështu, kështu e kishim. Të gjithë neve na lidhte ajo fuqi që ne të bahemi bashkë, që ju neve nuk mundeni me na rrënu, që ju neve nuk mundeni me na ndalë, shpirti ynë nuk mund të ndalet, nuk mund të mbyllet. Kjo ka qenë te të gjithë ne. Çdo njeni prej nesh e ka pasë ndonjë dert, ndonjë hall, shumica prej nesh kemi qenë të përjashtum prej pune. Ne ndoshta s’kemi pasë asnjë buzëkuq ta lyjmë në buzë, me gisht i nxjerrshim, veç koncerti ka m’u mbajt.

Koncertet tona kanë qenë të rrethume rreth e rreth me policë civil. E përcjellshim, na përcjellshin neve se ku jemi, kush jemi, kur po mbahet koncerti, kush çka po flet. Dhe më kujtohet unë e kam, kënaqësi e madhe, guximin e parë që e kam ba, publikisht herën e parë dikush që e ka thanë, “E gëzofshit Festën e Flamurit!” Me 28 nantor e kam thanë këtë publikisht dhe ka pasë polici edhe brenda në sallë ka pasë polici. Sa mirë nuk guxun asgja të më bajnë dhe kjo ishte fitore shumë e madhe, po ka qenë një koncert shumë i bukur.

**Donjetë Berisha:** Ku o mbajt?

**Indira Çipa:** Në Shtëpi të Kulturës, ‘92-ta, ‘93-ta, ‘94-ta. Mu më duket që për herë të parë e kam thanë ‘93-tën, mandej, ose ‘92-ta, ‘92 ose ‘93. Mandej ‘94 s’kish kush të na ndalë e ‘94-ta ishte 50 vjetori i “Agimit” edhe Anton Çetta ka qenë kryetar i parë i shoqërisë “Agimi” edhe pat ardh në festë edhe tha, “Për 60 vjetorin edhe nga gropa e varrit do të gëzohem për krenatën e ‘Agimit’”, fjalë shumë e bukur. Se e pa ai që ne po bëjmë punë të madhe aty, sepse nuk ishte vetëm kor ishte ansambli i valleve, ishte ansambli i kangtarëve, kishim orkestrinën. E pastaj për 50 vjetor, Ramiz Ymeri e kompozoi kantatën<sup>2</sup> për “Agimin”. Ne kemi këndu kantatë. Kantatë, nuk e di a e dini, kantata është një vepër mjaft e madhe, ka orkestër, ka recitatorë, kor, solo-kangtarë, edhe ajo vepër ka qenë shumë, shumë e bukur. Ka qenë për mrekulli edhe doli shumë e bukur edhe është një krenari që në kohën kur gjithçka mbyllshin, shkollat, insistacionet kulturore, arsimore, shëndetësore, gjithçka mbyllej, ne sikur grumbulloheshim aty dhe aty ne merrshim forcë. Veç kësaj shumë institucione pastaj fillunë veprimtarinë e vet me e lidhë me “Agimin”, për shembull shkolla e muzikës vepronte në lokalet e “Agimit”, pastaj teatri i qytetit.

**Donjetë Berisha:** Gjatë kohës kur o mbyll shkolla e muzikës a po?

**Indira Çipa:** Po, po!

<sup>2</sup> Latin. *cantare* është pjesë muzikore me karakter solemn, që këndohet nga një këngëtar a nga disa këngëtarë ose kori, të shoqëruar nga orkestra; këngë korale solemne.

**Donjetë Berisha:** Domethonë si sistem paralel?

**Indira Çipa:** Si sistem paralel, mësimet grupore mbaheshin në “Agimi”, ndërsa individuale i mbajshim nëpër shtëpitë tona. Se ka qenë ndërtesë e madhe dhe mbetëm pa hiç edhe “Agimi” nuk mjaftonte për mësimin tonë, por së paku qendrën aty e kemi pasë. Ndërsa mësimet individuale, këto të instrumenteve i mbajshim nëpër shtëpitë tona dhe nëpër shtëpitë e nxansave. Dhe një gja tjetër që ashtu shumë e vlefshme për kulturën shqiptare është një mbramje kulturore e tipit të kollazhit. Ne i qujshim ato mbramje artistike. Mbahej çdo të dytën shtune dhe në ato mbramje një libër promovohet, një ekspozitë hapej.

Ajo ekspozitë qëndronte për dy javë, derisa vinte ekspozita tjetër. Aktorët e teatrit recitonin i thonin vargjet ose pjesë nga libri që promovohet edhe një pjesë kishte edhe me asi, me pika muzikore, por muzikë serioze dhe kjo, krejt kjo zgjaste 60 minuta. Pas 60 minutave mandej vazhdonte ahengu. Dhe nuk e di në ka pasë ndonjë emër nga kultura kosovare që nuk ka qenë mysafirë aty. Unë e moderojsha atë edhe ka qenë një përvojë shumë e mirë. Një sallë e vogël që zinte 70, 80, jo 50 persona i zinte normalisht, po për ato 60 minuta edhe në kambë qëndroreshin njerëzit.

Shkonte numri prej 80 deri njëqind persona, bile ka qenë në katin e epërm, bile ishte problem mos po rrëzohet (qeshë) se s’ka qenë shumë mirë e ndërtume. Por kanë qenë të interesum çdo pjesë e popullatës, nuk është diçka që është elitare, që ka qenë elitare, veç për artistat ose veç për muziktarët ose veç për shkencën. Nuk ka pasë izolim, nuk ka qenë elitare. Kanë ardhë mjeshtrit, kanë ardhë bukëpjekësit, rrobaqepësit, mjektë, arqitektët, të gjithë kanë qenë brenda asaj. Edhe pas atyre 60 minutave që prezentohej ajo pasuri e arritjeve të artistëve të Kosovës, pastaj shoqëria [Agimi] këndonte vetë.

Ne i merrshim instrumentet, këndoreshin dhe ajo zgjaste qashtu, nja një orë ose nja dy orë. Ka qenë një mbramje shumë e mirë. Me Ali Podrimja, Azem Shkreli, ma përmendni dikënd! Prej piktorëve gati të gjithë Miradije Ramiqi, Haki Xhakli, Muslim Mulliqi, të gjithë, të gjithë kanë ardhë, kanë ba ekspozita, kanë prezantuar libra, kanë diskutu për situata të ndryshme edhe kjo e ka rritë edhe namin edhe funksionin edhe e ka vendosë “Agimin” në një pozitë shumë të randsishme edhe në histori sepse i ka zavendsu mungesat në tanë Kosovën.

**Ardita Avdija:** Po du me u lidh aty te kangtë që i keni këndu apo ato pikat artistike, a mundeni me na e përmend pak cilat kanë qenë ato që u bo meniherë reminishencë, të gjithë asaj?

**Indira Çipa:** Po, ne jemi përqendru ma shumë në vepra korale të kompozitorëve shqiptarë.

**Ardita Avdija:** Për shembull?

**Indira Çipa:** Për shembull Fahri Beqiri, Çesk Zadeja, Rexho Mulliqi, [Rafet Rudi](#), këta kanë qenë autortë, kangtë, Fahri Beqirin, po e përmenda, “Erdh Misiti”, “Gjike Loke”, pastaj, i harrova kangtë, “Shami Kuqja”. Këto kangtë kosovare kryesisht, por edhe të Shqipërisë, por, jo shumica, po të gjitha kanë qenë shqip. Nuk kemi praktiku një literaturë evropiane, për shembull me marrë frangjisht, e anglisht, sepse



koha ishte ne i kultivojshim vetëm kangtë tona edhe kalonin shumë bukur ato në publik. Kemi pasë një pranim shumë të mirë nga ana e publikut, pa marrë parasysh që ndoshta për një kohë të caktuar përpara asaj kohe, publiku ka qenë ma shumë i orientuar kah muzika popullore.

Por në kohën kur u riaktivizua kori, u begatu puna e korit kaq shumë, kori ka pasë një adhurim të veçantë nga ana e publikut edhe gjithmonë prezantoheshim me tre deri pesë kangë, edhe zakonisht ishim në fillim të programit sepse fillimin e konceptojshim ashtu. Shkonte kori edhe mandej shkojke, shkonte kjo pjesa e muzikës folklorike edhe popullore. Edhe në kangë kishim dy, dy zhanre, edhe ato burimore edhe ato popullore - qytetare dhe kjo krahasasi kultivohej edhe kështu.

**Ardita Avdija:** Pas zhvillimit tënd profesional edhe pas asaj shijes së shoqnisë “Agimi”, çka të ka mbetë diçka, çka mundesh me na përmend ose ke dëshirë me na përmend, që të ka shty ty pastaj me marrë rrugën e pianos dhe me realizu krejt arritjet e tua profesionale?

**Indira Çipa:** Mu më duket që unë i kam jetu dy jetë menjëherë, dy jetë menjëherë. Kjo është një botë tjetër, muzika serioze është një botë tjetër. Të merresh me nxansa dhe me studenta, t’i edukosh ata, brenda asaj, është diçka që është edhe shumë profesionale edhe bazohet, edhe mundet me funksionu vetëm mbi bazën e një dashurie të fortë me një elokuencë shumë të fortë. Ndërsa këtë aktivitetin në “Agimi” unë e trajtoj sikur një dhuratë për kombin, diçka që është shpirtërore dhe që është ndoshta kashta e fundit për të cilën unë jam kap, jo vetëm unë por edhe të tjerët.

Është një dhuratë edhe për kombin, një dhuratë për qytetin, por është një përfitim shumë i madh, se unë kam marrë shumë dashuri prej atij aktivitetit, unë kam marrë shumë lavde prej atyne aktiviteteve. Unë jam shumë e sigurt që njerëzit janë të vetëdijshëm që unë e kam dhanë shpirtin për një ngjarje të tillë dhe jo vetëm unë. Dhe unë kam qenë aty sepse të gjithë të tjerët kanë qenë aty. Ne të gjithë e kemi deshtë atë punë, ne të gjithë e kemi deshtë atë aktivitet. Nuk muj me thanë që njena ka ndiku në tjetrën, por muj me thanë që asnjëra pa tjetrën s’ka mund të baj. “Agimi” është Indira-njeri, ndërsa pianoja është Indira-profesion. Edhe pse, si brenda njenës, si brenda tjetrës, ka shumë, nuk ka art pa dhënë zemrën.

**Ardita Avdija:** Deri në cilin vit ke qenë pjesë e “Agimit”?

**Indira Çipa:** Prej vitit ‘90 deri në vitin ‘97 kam qenë shumë aktive. Pastaj aktiviteti pakëz ka ra sepse unë atëherë fillova të punoj në Universitetin e Tetovës edhe kam qenë pak ma, jo ‘97 deri ‘96-tën, kam qenë pak ma anash dhe ‘97-tën ma filloi të acarohet situata. ‘98-tën ma edhe ma vështirë ishte dhe shumë pak kemi mujtë me vepru. Po unë për shkak të punës atje unë isha pak ma e tërhekun në aktivitete. Edhe pastaj pas luftës përsëri pakëz i bëra disa aktivitete dhe ishte koha për të tjerët pastaj le të punojnë të rinjtë a?

**Donjetë Berisha:** E para se me kalu në universitet në Tetovë, çka keni punu këtu në Kosovë, se më duket e përmende edhe ma herët?

**Indira Çipa:** Unë në vitin 19...

**Donjetë Berisha:** Nëse mundeni vetëm me na tregu, kur keni diplomu prej Universitetit të Arteve, mandej çka keni bo mas asaj periudhe?

**Indira Çipa:** Po, kur u regjistrova në fakultet, unë fillova njëkohësisht të punoj edhe në televizion. Kam punu si spikere në televizion.

**Donjetë Berisha:** Në cilin?

**Indira Çipa:** Në televizionin e Prishtinës, i vetmi (qeshë), i vetmi ka qenë deri në vitin '85 atëherë absolvova edhe drejtori i shkollës të Prizrenit më ftoi. Tha, "Ne s'kemi pianistë, ti e ke borxh m'u kthy". Edhe unë u ktheva në Prizren si profesorëshë e pianos edhe aty punova shumë edhe në korepeticion edhe me nxansa. Për njëzetë vjet kam qenë e pandërpreme në punë. Domethanë, ky aktiviteti i "Agimit" ka qenë krahas asaj edhe në '96 ose '97-tën, tash mund të gaboj, pikërisht në "Agimi" erdhën, i kishim mysafirë piktortë edhe edhe një poet prej Maqedonisë, prej Tetove edhe prej Gostivari.

Edhe atë mbramje ne kishim aktivitetin e tyne, përpos asaj unë edhe lujta edhe në piano. Edhe tash piktori që ishte mysafirë Meli Zenku, ishte edhe prodekan në fakultet në Tetovë, edhe tha, "Profesorëshë" tha, "po ne kemi nevojë shumë për pianista. Ne sa e kemi hapë" tha, "fakultetin në Tetovë. A mundesh me ardhë te ne?" Thashë, "Po, pse jo?" Edhe më propozoi, m'u ba qefi. Edhe shkova atje, fillova edhe deri në vitin 2004 unë kam dhanë mësim edhe atje. Edhe kështu, po vazhdimisht edhe Prizrenin edhe Tetovën kështu e kam menaxhu atë kohë.

Edhe pastaj pas çlirimit në vitin 2001 më ftuan të konkuroj për drejtoreshë për kulturë, sport dhe rini në Komunë të Prizrenit. U zgjodha drejtoreshë për gjashtë muj sa e kisha kontratën, ma tutje s'deshta me vazhdu, aq sa e kisha kontratën. U banë disa punë të mira, atëherë ishte prioriteti, minoritetet ishin prioritet. Me një aktivitet shumë të madh me bashkëpunim me këto organizata jo-qeveritare të hujat. Nja nantë shtëpi të kulturës janë renovu nëpër fshatra, për boshnjakë edhe për turq. E bana renovimin e Qendrës Sportive [cingëron telefoni].

**Donjetë Berisha:** A mundesh veç edhe mu ndal ndoshta pak te lufta, me përshkru çka ndodhë, domethonë kur keni gjatë luftës, edhe mandej me vazhdu me pjesën mas luftës?

**Ardita Avdija:** Edhe me vazhdu te jeta sot qysh osht'.

**Indira Çipa:** Mhm... Qysh me e ndal bre këto?

**Donjetë Berisha:** Zonin a, zonin a?

**Indira Çipa:** Krejt me nal, qe, qe krejt p'e nali. Hajde, *power off* [anglisht - fikja ], hajt. Po luftën e lamë a po?

**Donjetë Berisha:** Mundeni me vazhdu qët pjesë mandej vazhdoni për mas luftës.

**Indira Çipa:** A po doni në detale a po?

**Donjetë Berisha:** Mundesh në detale, s'osht problem.

**Indira Çipa:** Edhe mu lufta më zuri në rrugë Prizren-Tetovë. Lufta ishte në jehun e madh. Unë udhëtimin s'e ndalova edhe një ditë mbrina në fakultet edhe studentët po më thojnë, "Profesoreshë, mos shko mo se keq është, tepër keq është". Thashë, "Sa të ecë autobusi, unë do të eci, unë do të vi". Tha, "Profesoreshë, nuk ta merr mendja, mbramë kemi bajtë shumë të plagosun". Studentat e mi kishin bajt tanë natën, edhe thashë, "Nuk më gjen gja". Shkova atëhere, ata, "Të lutem rri. Unë, "Jo!" U ktheva në Kosovë edhe njëherë udhëtova edhe në mbetëm, mo s'kishte as sheqer, as vaj, as kurgjo. Lufta mo në asi, edhe thashë, "Masi po shkoj" thashë, "atje të marr vaj edhe sheqer".

## Pjesa e Dytë

**Indira Çipa:** Ky është ai detaj që unë po du me thon, shumë i imët, por që është jeta është thelbi, thelbi i vujtjes. Mora nja tre-katër litra vaj, nja katër-pesë litra, katër-pesë kilogram sheqer, por rrugës t'u shku ende s'i kam marr ato, t'u shku rrugës u ndala edhe kërkitën granatat në anën e djathtë, autobusi qysh ishim në brenda lëvizi, bash në kufi, edhe lëvizi autobusi edhe u kthy. Shkova unë mbajta mësim, rrugës mora sheqer edhe vaj edhe na pruni autobusi veç deri në kufi, nuk shkon ma kënde, u deshke me marr autobus tjetër e me hec në kambë. E di më kujtohet isha me një koleg me atë peshë nëpër durë, vetëm qetë ndëgjoheshe edhe kërcimat. Nuk e di si mbrinëm diqysh deri te Hani i Elezit, erdhëm kënde, mbrina në shtëpi, të nesërmen u mbyll kufini edhe mbetëm. Por shyqyr që kam mbetë këtu, mirë që s'kam mbetë atje. Isha çmend, pa prindërit, pa motrat, krejt i kisha këtu. Unë për luftën nuk kam folë kurrë edhe s'muj me folë, veç flas ndonjëherë ndonjë detaj (qanë).

**Ardita Avdija:** Për bombardime ku keni qenë?

**Indira Çipa:** Edhe bombardimet deri me 1 maj [1999] kemi qenë këtu, në Prizren edhe familja, motra ime punonte atëhere për OSBE-në<sup>3</sup> mandej OSBE-ja u tërhoq ajo ishte shumë rrezik. Neve na përjashtunë, na përzunën prej shtëpisë me kërcënime, e kërcënuan babën tim se do ta vrasin nëse...

**Ardita Avdija:** A ka qenë familja jote e përfshime politikisht gjatë luftës?

**Indira Çipa:** Po nuk muj me thanë që, ne s'kemi bo ndonjë aktivitet kështu të veçantë. Domethonë, nuk kemi qenë në luftë asnjëri, se baba jonë në moshë edhe ne të gjitha femra. Ne s'kemi qenë të përfshime në luftë, por s'ka pasë nevoj të jesh i përfshim në luftë, ka mjaftu me qenë shqiptarë edhe të... edhe kështu na përzunën prej shtëpisë, nja dy-tre javë ishim jashtë shtëpisë. Mbas dy dite na e plaçkitën shtëpinë, na e demolun e sende. Mandej me 1 maj u detyrum me dalë jashtë sepse motrën e kisha të rrezikume sepse i kërkojshin njerëzit që kanë punu në organizata të huaja, edhe ne dolëm diqysh, shkuam në Mal te Zi, shkum në Ulqin.

<sup>3</sup> Organizata për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë

Prindërit mbetën por ditën e çlirimit, atë ditë kur ka hy NATO-ja edhe UÇK-ja kur ka hy, njëri prej sërbeve që ka mbetë aty afër ka dalë edhe ka shti sepse në oborrin tonë kanë hy ushtarët prej gëzimit. Prindërit e mi i kanë pritë e ju kanë dhanë strehime, janë la e janë ushqy e sende. Kojshitë prej gëzimit, se baba jem ma i moshuar aty në mahallë, kanë ardhë me ja uru, ai del aty naltë edhe fillon me gjuajt [fqinji]. Baba për me i mbrojtë mysafirët që i ka pasë e hap dritaren e katit të parë, ata futen prej dritares e vet shkon shkallëve edhe aty e zen plumbi. Por ai ka shpëtu dhe ende është gjallë, shumë mirë është, është 90 vjeçar, e qështu.

Kur u kthyem mirë i gjetëm, shëndosh edhe mamin edhe babin, por shtëpia ishte shumë e demolume, por në anën tjetër e kishim dertin e motrës tjetrës, të cilës ja kishin djegë shtëpinë krejt. E kishim hallin e motrës tjetër që e kishin deportu në Maqedoni edhe ata dojshin me shku në Amerikë e mandej diku prej asaj rruge janë kthy, nuk kanë shku në Amerikë kanë shku në Turqi, mbetën atje deri sa i kthyen deri sa erdhën, po u bashkum mirë jemi. Mas luftës çka do që ka qenë të gjithë kemi qenë shumë të lumtur.

Është një shpejtësi e çuditshme me të cilën ne i jemi kthy jetës, i jemi kthy jetës tu i llogaritë, i llogaritshim humbjet, por babai im e thotë një fjalë, thotë, “Pasuria, kamja nuk e bën njeriun, njeriu e bën pasurinë”. Nëse të ka shku shpia ti je gjallë ti ke me e ba edhe kështu të gjithë ju përveshëm [punës]. Na e bëm një renovim në shtëpi, filluam me punu. Unë iu riktheva shkollës muzikës, fillova me nxansa, fillova me punu me nxansa shumë, e kisha një nxënëse shumë të mirë Genita Hoxha, ajo e ka ble pianon në valë të luftës, gjithkrah kërshitke, po ne sikur nuk dojshim me besu që ka me shku, aq ashpër ka mu bo.

E ka ble pianon edhe mo e humba, mo u ndalën telefonat u ndalën radiot u ndal televizioni, s’kishte informata fare, une nuk disha çka po ndodhë me te. A e di shumë mirë që baba i saj i ka dhonë paret e fundit që i ka pasë edhe plus kishte marrë diçka borxh për me ja ble pianon vajzës për me mujt ajo me përparu. Thashë athua kanë me pasë pare me ikë, a kanë me pasë mundësi me ikë. Edhe mandej kur u takum filluam me punu shumë mas lufte, unë shpejtë e shpejtë ia organizova, ajo shumë e vyshme ka qenë, ia organizova një koncert në Qendrën Kulturore Franqeze në Izmir, përmes zyrtarit regional për arsim ishte një franqez Daniel Schloser edhe ai donte me bo diçka për neve që dija jonë të tregohet dikund.

Mandej kur shkoi ai në Izmir si përfaqësues i Francës në ambasadën franqeze, në konsulatë në të vërtetë ishte drejtori i Qendrës Kulturore në Izmir edhe ia organizum një koncert. Në mesin e donatorëve që e organizuan këtë koncertin e saj ishte edhe një gjerman Armindyr edhe mandej kur u kthym ne të gjitha dokumentet që dolën nga projekti, ne ia quam atij një ekzemplar që iu bë qejfi shumë, por tha edhe unë mundem me e organizu një koncert. Mbas disa muajve ne me të njejtin koncert shkuam edhe në Gjermani, e mbajti edhe atje një koncert, domethonë menjëherë mbas koncertit edhe nëse rrugët tona nuk kanë qenë të hapura, ne e kemi ndi sikur janë të hapura.

Sot ne shumë diskutojmë për vizat, e jo liberalizimi i vizave andej-këndej, mirë është t'i kemi edhe duhët t'i kemi, por kur njeriu don me arritë diçka, don me tregu dicka kur don të dëshmohet, kur ajo që bon është krenari edhe për popullin e vet nuk ka pengesë për me arrit, mundet me arrit. Edhe liberalizimi i vizave do të bëhet, me siguri do të bëhet, por ne s'kemi nevojë me vajtu pse s'i kemi, ne duhet të bojmë që t'i thejmë ato pengesa. Çkado që dojmë, cilëndo liri që dojmë me arritë, ne duhet të bëjmë që ajo të arrihet. Nëse diçka nuk është arritë nuk na ka faj dikush tjetër, ne jemi ata që duhet ta bajmë edhe vetëm kështu.

**Ardita Avdija:** Jeta sot, qysh është një ditë e zakonshme për ty me gjithë aktivitetet e saj?

**Indira Çipa:** Unë zgjohem në mëngjes në ora gjashtë edhe mbaj mësim nga dita në dite, merrem me shkrimet tash kohët e fundit, se dija është grumbullu pakëz. Edhe tash unë po merrem me shkrime, marr pjesë në konferenca shkencore, botoj punime shkencore e kështu. I kam dy libra të botuara, punoj me nxansa në shkollë të muzikës këtu në “Prenk Jakovë” në Prishtinë, punoj në Fakultetin e Arteve edhe aty kam mësim, kam edhe një kurs në shtëpi kursin e pianos që e mbaj. Jam duke doktoruar, jam në ditët e fundit që jam duke e përmbyll mo punimin, këto janë angazhimet e mia tash momentalisht.

Ato angazhime që i kam pasë si ma e re kur kam qenë, jo “Agimi”, jo aktivitete të lira, aktivitete të bamirësisë, po për ato mo thjesht nuk ka kohë për ato sepse po du edhe këtë pjesën tjetër. Edhe këtë dituri që e kam grumbullu prej vitesh, po du diqysh ta dokumentoj, ta argumentoj edhe ta publikoj, e kjo po kërkon shumë punë. Kështu që, e hane është mësim prej orës tetë në mëngjes deri në ora shtatë në mbramje, të martën kam mësim më pak por ma shumë shkrim punë në tavolinë, e mërkura është e përmbushun me punë në tavolinë, të enjten mësim prej orës tetë deri në ora shtatë, e premtja është pak më e shkarkume, të shtunden përsëri kam pak mësim por më shumë shkrim. Kështu që, kjo është e përmbushun me shumë punë, e përmbushun.

**Ardita Avdija:** E përmende që jep mësim privat edhe nxansave të cilët dojnë me mësu për piano, a mendon që ka interesim në këtë aspekt sa i përket rinisë Kosovare për instrumentet muzikore?

**Indira Çipa:** Po shikoni, ne pedagogët ndonjëherë ma shumë merremi me idhnimet se sa me gëzimet por edhe gëzimet janë shumë të mira sepse idhnimet janë ato që sikur refuzojmë me pas ndonjë nxanës të dobët, kemi qef të gjithë me qenë shumë të mirë. Por tash kur mendoj unë për punën që kam ba, deri tash i kam nja gjashtë nxansa që kanë kry te unë deri në shkollën e mesme dhe që janë të përhapun nëpër botë dhe kanë karrierë edhe koncertale edhe pedagogjike pianistike. Nji e kam në Michigan, një e kam në Gjermani, një e kam në Austri, një është në Turqi edhe një është në Shqipëri. Domethonë, janë njerëz të cilët ja kanë pa hajrin kësaj pune.

Në anën tjetër, me punën që unë kam ba me ata fëmijë deri qetash i kam diku rreth, nja 15 shpërblime; do të para, do të dyta, do të treta. Vetëm vitin e kaluar kam realizuar nëntë shpërblime në garat ndërkombëtare. Sivjet janë realizu dy shpërblime të para gjithashtu në garat ndërkombëtare, dhe kur

flasim kështu për këto shifra, atëhere mund të themi se rinia jonë është e interesume, ka impuls krijues, dojnë me punu. Por në mesin e tyre ka edhe të atillë që nuk janë shumë të vullnetshëm, por kjo është jeta, ky është një proces brenda të cilit ne përzgjedhim me kriju artista të mirë dhe nuk mund të mos jemi të kënaqur edhe pse unë kam qejf me qenë pak më të mirë, por kështu jemi (qesh).

**Ardita Avdija:** Prej krejt çka ti mban në mend edhe çka ti ke botu prej fëmijërisë deri në ditët e sotme, a mendon se krejt çka është që ti ke kalu të ka përmbush ty të gjitha pritshmëritë e tua, shpirtërore, profesionale, të gjitha?

**Indira Çipa:** Plotësisht, plotësisht më ka përmbush. Kohën ma ka marr komplet, zemrën ma ka marr komplet. Më ka sjellë gëzime, më ka sjellë edhe hidhërime, por shoqëria jonë nuk është ende shumë e aftë që vlerat t'i shoh edhe s'ka edhe kohë që t'i shohë, sepse ka momente që unë mendoj që ajo që kam ba është ma e vlefshme se sa që, se sa që të tjerët janë në gjendje ta lavdërojnë. Por është një satisfakcion i madh për mu, që unë brenda rrethit tim ku unë veproj, ku punoj, për shembull nxansat e mi studentat e mi që ju jap dije në mënyrën time personale, mu më ka rastisë për vetën të dëgjoj, “Profesoreshë, perëndia, pas perëndisë ti”. Domethonë, kjo është ajo që të përmbush ose, “Të kam si nanën e dytë” ose “Të falemnderit, ti ma ke hap rrugën e jetës”.

Të premtën më ndodhi, mbrina në Prizren edhe vetëm ndëgjoj dikush bërtet “Profesoreshë!” në rrugë, kthehem mbrapa dhe e shoh nxansen time. Ajo po mbërrin prej Amerike prej Michiganit po mbërrinë, nana vet e ka marr prej aeroportit kjo kur më ka pa mu gjysën e trupit jashtë veturës “Profesoreshë!” E nali veturën doli erdh më për qafi edhe nisi me qajtë, “Falemnderit, këtë që e kam prej teje e kam”. Domethonë, këto janë ato satisfaksionet. Ndonjëherë idhnohemi e lodhemi sende, por mjafton një fjalë e këtillë, një parë lot të gëzimit ose të falenderimit dhe me ta përmbushë jetën, me thanë unë jam në rregull me Zotin dhe veten, kaq.

**Ardita Avdija:** Nuk po mundem pa u kthy edhe një herë te shoqëria kulturore e “Agimit”, çka është diçka që ty të mungon më së shumti prej asaj kohe që kishe dashtë me e veçu, diçka që thu nëse ish kthy koha qeky kish qenë sendi që kisha dashtë me përrjētu edhe një herë sa ke qenë aty?

**Indira Çipa:** Është diçka tjetër që mu po më dhemb, unë aq shumë e kam deshtë atë “Agimi” atëhere saqë po më duket që në atë kohë s'ka mund të bahet ma mirë. Por une e kam një dhimbje tjetër që unë kujtoj që ai “Agimi” i asaj kohe, atë punë edhe atë kontribut që e ka ba sikur nuk është tu e vazhdu forcën që e ka, mua ajo po më dhemb. Unë kujtoj që “Agimi” duhet ta ketë një trajtesë të mirë, ni trajtim, me trajtu mirë ministria edhe me i dhanë një epitet tjetër për punën që ka ba. Nji status m'i dhanë, një mbrojtje, me e marr nën mbrojtje si trashëgimi kulturore për hirë të aktiviteteve që i ka bo nga '44-ta deri në vitin '99 dhe për veprimtarinë e sotshme të gjindet një modus tjetër në mënyrë që të ruhet, sepse aty mund të jepen vlera ende, por duhet të ndryshoj sepse mo nuk është ajo kohë, tash është një kohë tjetër. Tash duhet të ndryshoj edhe në qeverisje domethonë, në menaxhim, si menaxhohet edhe në vlerat të reja, edhe në përmbajtje të reja me dhanë përmbajtje të reja, sepse mundet, kjo është ajo dhimbje. Domethonë, dhimbja nuk është e asaj kohe është dhimbja tash që mu

po më brenë. Ndoshta kanë me gjetë ndonjë modus për veprimtari më të mirë, ta shofim.

**Ardita Avdija:** A kishit dashtë me shtu diçka, nëse ke a po?

**Indira Çipa:** Unë veç deshta ta përmendi edhe një... se e përmenda njëhere kantatën, atë kantatë që e kemi pasë për 50 vjetorin e “Agimit” atë ne e kemi shfaqë edhe në kishën e Prizrenit me rastin e promovimit të përkthimit të “Biblës” edhe ai rast ka qenë shumë i randësishëm për kulturën shqiptare edhe për historinë e shqiptarëve edhe po du me e cekë edhe një aspekt tjetër të rolit të “Agimit” sepse në ato kohëra “Agimi” ka bashkëpunu shumë edhe me kishën katolike edhe me komunitetin musliman, ne kemi shfaq koncerte edhe në kishë, kemi shfaq koncerte, kemi këndu edhe në xhami me rastin e solemniteteve ose ditëve të caktuara. Domethonë edhe këtu ka një rol të madh “Agimi”, këte veç deshta me, me e theksu.

**Donjetë Berisha:** Faleminderit shumë!

**Indira Çipa:** S’ka gja!